

VENDIM
Nr. 355, datë 29.5.2019

**PËR PËRCAKTIMIN E SPECIFIKIMEVE TË MEDALJEVE TË MIRËNJOHJES
PUBLIKE DHE TË VLERËSIMIT PROFESIONAL QË JEPEN NGA
KRYEMINISTRI**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 8, pika 2, 13, dhe 26, pika 1, të ligjit nr. 112/2013, "Për dekoratat, titujt e nderit, medaljet dhe titujt vendorë të nderit në Republikën e Shqipërisë", me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Modeli dhe përshkrimi i medaljeve që jepen nga Kryeministri janë sipas specifikimeve të përcaktuara në shtojcën 1, bashkëlidhur këtij vendimi.

2. Dhënia e medaljeve shoqërohet me një certifikatë. Format i certifikatës është një letër format A4, me peshë 160 g, me logon e institucionit, e kornizuar me ngjyrat e shiritit të medaljes. Në qendër vendoset shenja e medaljes dhe teksti me këtë përmbajtje: "Z./Znj._____, Kryeministër i Shqipërisë, i akordon z./znj.____ llojin e medaljes, nr. rendor. Tiranë, më ____/____/____".

3. Medalja e Kryeministrit për Mirënjohje Publike përbëhet nga tri klasa:

- I: Kordoni i Madh me Yll i Mirënjohjes Publike;
- II: Ylli i Madh i Mirënjohjes Publike;
- III: Ylli i Mirënjohjes Publike.

4. Medalja e Kryeministrit për Vlerësim Profesional është e përbërë nga tri klasa:

- I: E artë;
- II: E argjendte;
- III: E bronzte.

5. Dhënia e medaljeve bëhet me një ceremoni zyrtare, e cila organizohet nga autoriteti që jep medaljen.

6. Individët të cilët janë dalluar me Medaljen e Mirënjohjes Publike përpara hyrjes në fuqi të këtij vendimi asimilohen me mbajtësit e klasit III – Ylli i Mirënjohjes Publike dhe kanë të drejtë të mbajnë shenjat përkatëse, sipas parashikimeve në këtë vendim.

7. Medalja e Kryeministrit për Mirënjohje Publike i hiqet titullarit të saj për arsyet e mëposhtme:

- a) ka dënim gjyqësor të formës së prerë për kryerjen e një veprë të rëndë penale;
- b) ka dënim gjyqësor të formës së prerë me burgim pa kusht, për një vit ose më shumë.

8. Medalja mund t'i hiqet titullarit të saj ose të jetë objekt pezullimi pa afat kur titullari është dënuar për një vepër penale që cenon figurën, ndershmërinë dhe moralin e tij si dhe besueshmërinë tek të tretët. Titullari është i detyruar të kthejë shenjat e medaljes me të cilën ka qenë i dekoruar.

9. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, përballohen nga buxheti i miratuar për Kryeministrinë.

10. Ngarkohet Kryeministria për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Erion Braçe

YLLI I MIRËNJOHES PUBLIKE



MEDALJA E KRYEMINISTRIT PËR
MIRËNJOHJE PUBLIKE, KLASA III

Përshkrimi: Medalja ka formën e një ylli me 36 cepa i cili ka një gjatësi 50mm dhe gjërësi 43mm me spesor 2mm.

Në qendër të saj është e vendosur shqiponja dykrenare e Gjergj Kastriotit-Skënderbeut e gdhëndur në relief me gjatësi 22mm dhe gjërësi 20.5mm me spesor 2mm.

Ylli është i kapur më lart në një kurorë ku janë ndërthurur bashkë gjethet e dushkut dhe të dafinës e cila lidhet në fund me një fjongo ku midis të dyjave krijohet çerniera e cila e mundëson medaljen të jetë e lëvizshme dhe jo statike.

Kurora e dushkut dhe dafinës e gdhëndur në relief ka një gjatësi 25mm me gjërësi 25mm me spesor 2mm. Kurora është e kapur lart me dy hallka që bëjnë lidhjen me kapsen të gdhëndur me motiv që mbërthehet rreth shiritit të medaljes si në figurë.

Kapsja ka një gjatësi 22mm dhe gjërësi 4.8mm në të cilën mund të kalojë një shirit me gjërësi 30mm. Shiriti i kësaj medalje ka gjërësi 30mm dhe gjatësi totale 85cm, gjatësi e cila është e ndryshueshme sipas qafës. Në mes të shiritit ku qëndron e varur medalja krijohet një lule e cila realizohet sipas të gjitha medaljeve standarte me kordon.

Medalja ka të shënuar në pjesën e prapme fjalën "Benemerenti" dhe, eventualisht, logon e kompanisë prodhuese.

Materiali: Medalja është e gjitha në Bronz e galvanizuar në Ar (Au 1000/1000) me shtresë të ndërmjetme Palladium.


Trajtimi i ngjyrës së Yllit në qendër është bërë me emalio (enamel) në ngjyrën e kuqe të flamurit me kodin pantone C = 0 M = 100 Y = 100 K = 0

Kurora me gjethe dushku dhe dafine është trajtuar me emalio (enamel) jeshile me kodin pantone C = 75 M = 30 Y = 90 K = 40

E gjithë medalja është veshur me një shtresë lacquer (llak) e cila e mbron nga oksidimi.

Shiriti i medaljes është mëndafsh i ujëzuar ngjyrë e zezë me një shirit të kuq në mes.

YLLI I MADH I MIRËNJOHES PUBLIKE



MEDALJA E KRYEMINISTRIT PËR
MIRËNJOHJE PUBLIKE, KLASA II

Përshkrimi: Medalja ka formën e një ylli me 36 cepa i cili ka një gjatësi 60mm dhe gjërësi 51mm me spesor 2mm.

Në qendër të saj është e vendosur shqiponja dykrenare e Gjergj Kastriotit-Skënderbeut e gdhëndur në relief me gjatësi 22mm dhe gjërësi 20.5mm me spesor 2mm.

Ylli është i kapur me lart në një kurorë ku janë ndërthurur bashkë gjethet e dushkut dhe të dafines e cila lidhet në fund me një fjongo ku midis të dyjave krijohet çerniera e cila e mundëson medaljen të jetë e lëvizshme dhe jo statike.

Kurora e dushkut dhe dafinës e gdhëndur në relief ka një gjatësi 26mm me gjërësi 26mm me spesor 2mm. Kurora është e kapur lart më dy hallka që bëjnë lidhjen me kapsen të gdhëndur me motiv që mbërthehet rreth shiritit të medaljes si në figurë.

Kapsja ka një gjatësi 35mm dhe gjërësi 4.8mm në të cilën mund të kalojë një shirit me gjërësi 50mm.

Shiriti i kësaj medalje ka gjërësi 50mm dhe gjatësi totale 85cm, gjatësi e cila është e ndryshueshme sipas qafës. Në mes të shiritit ku qëndron e varur medalja krijohet një lule e cila realizohet sipas të gjitha medaljeve standarte me kordon.

Medalja ka të shënuar në pjesën e prapme fjalën "Benemerenti" dhe, eventualisht, logon e kompanisë prodhuese.


Materiali: Medalja është e gjitha në Bronz e galvanizuar në Ar (Au 1000/1000) me shtresë të ndërmjetme Palladium.

Trajtimi i ngjyrës së Yllit në qendër është bërë me emalio (enamel) në ngjyrën e kuqe të flamurit me kodin pantone C = 0 M = 100 Y = 100 K = 0

Kurora me gjethe dushku dhe dafine është trajtuar me emalio (enamel) jeshile me kodin pantone C = 75 M = 30 Y = 90 K = 40

E gjithë medalja është veshur me një shtresë lacquer (llak) e cila e mbron nga oksidimi.

Shiriti i medaljes është mëndafsh i ujëzuar ngjyrë e zezë me një shirit të kuq në mes.



MEDALJA E KRYEMINISTRIT PËR MIRËNJOHJE PUBLIKE, KLASA II

Pershkrimi: Medalja e dytë që shoqëron medaljen “YLLI I MADH I MIRËNJOHJES PUBLIKE” ka formën e një ylli me 36 cepa i cili ka një gjatësi 80mm dhe gjërësi 68mm me spesor 2.6mm.

Në qëndër të saj është e vendosur shqiponja dykrenare e Gjergj Kastriotit-Skënderbeut e gdhëndur në relief me gjatësi 36mm dhe gjërësi 33mm me spesor 2mm.

Në pjesën e prapme është vendosur kapsja e medaljes e cila është realizuar sipas medaljeve standart sot në botë.


Medalja ka të shënuar në pjesën e prapme fjalën "Benemerenti" dhe, eventualisht, logon e kompanisë prodhuese.

Materiali: Medalja është e gjitha në Bronz e galvanizuar në Ar (Au 1000/1000) me shtresë të ndërmjetme Palladium.

Trajtimi i ngjyrës së Yllit në qëndër është bërë me emalio (enamel) në ngjyrën e kuqe të flamurit me kodin pantone C = 0 M = 100 Y = 100 K = 0

E gjithë medalja është veshur me një shtresë lacquer (llak) e cila e mbron nga oksidimi.

KORDONI I MADH ME YLLI I MIRËNJOHES PUBLIKE



MEDALJA E KRYEMINISTRIT PËR MIRËNJOHJE PUBLIKE, KLASA I

Përshkrimi: Medalja ka formën e një ylli me 36 cepa i cili ka një gjatësi 70mm dhe gjërësi 59mm me spesor 2.5mm.

Në qendër të saj është e vendosur shqiponja dykrenare e Gjergj Kastriotit-Skënderbeut e gdhëndur në relief me gjatësi 31.5mm dhe gjërësi 29mm me spesor 2mm.

Ylli është i kapur më lart në një kurorë ku janë ndërthurur bashkë gjethet e dushkut dhe të dafinës e cila lidhet në fund me një fjongo ku midis të dyjave krijohet çerniera e cila e mundëson medaljen të jetë e lëvizshme dhe jo statike.

Kurora e dushkut dhe dafinës e gdhëndur në relief ka një gjatësi 28mm me gjërësi 28mm me spesor 2mm.

Kurora me gjethe që mban edhe medaljen e yllit është e kapur në qendër të fjongos së kordonit me hallkë si në foto. Shiriti i kordonit ka gjërësi 100mm dhe gjatësia e kordonit është e ndryshueshme në bazë të përmasave të trupit.

Medalja ka të shënuar në pjesën e prapme fjalën "Benemerenti" dhe, eventualisht, logon e kompanisë prodhuese.

Materiali: Medalja është e gjitha në Bronz e galvanizuar në Ar (Au 1000/1000) me shtresë të ndërmjetme Palladium.

Trajtimi i ngjyrës së Yllit në qendër është bërë me emalio (enamel) në ngjyrën e kuqe të flamurit me kodin pantone C = 0 M = 100 Y = 100 K = 0


Kurora me gjethe është trajtuar me emalio (enamel) jeshile me kodin pantone

C = 75 M = 30 Y = 90 K = 40

E gjithë medalja është veshur me një shtresë lacquer (llak) e cila e mbron nga oksidimi.

Shiriti i medaljes është mëndafsh i ujëzuar ngjyrë e zezë me një shirit të kuq në mes.

KORDONI I MADH ME YLLI I MIRËNJOHES PUBLIKE



MEDALJA E KRYEMINISTRIT PËR MIRËNJOHJE PUBLIKE, KLASA I

Përshkrimi: Medalja e dytë që shoqëron medaljen “KORDONI I MADH ME YLLI I MIRËNJOHJES PUBLIKE” ka formën e një ylli me 36 cepa i cili ka një gjatësi 90mm dhe gjërësi 76mm me spesor 2.7mm.

Në qendër të saj është e vendosur shqiponja dykrenare e Gjergj Kastriotit-Skënderbeut e gdhëndur në relief me gjatësi 40mm dhe gjërësi 37mm me spesor 2mm.

Në pjesën e pasme është vendosur kapsja e medaljes e cila është realizuar sipas medaljeve standart sot në botë.

Medalja ka të shënuar në pjesën e prapme fjalën "Benemerenti" dhe, eventualisht, logon e kompanisë prodhuese.

Materiali: Medalja është e gjitha në Bronz e galvanizuar në Ar (Au 1000/1000) me shtresë të ndërmjetme Palladium.

Trajtimi i ngjyrës së Yllit në qendër është bërë me emalio (enamel) në ngjyrën e kuqe të flamurit me kodin pantone C = 0 M = 100 Y = 100 K = 0

E gjithë medalja është veshur me një shtresë lacquer (llak) e cila e mbron nga oksidimi.

MEDALJA E ARTË PËR VLERËSIM PROFESIONAL



Përshkrimi: Medalja e Artë për Vlerësim Profesional ka diametër 40mm dhe spesor 3mm.

Në qendër të saj është e vendosur emblema e Kryeministrit, Shqiponja dykrenare e gdhendur në relief mbi të cilën është vendosur përkrenarja e Skënderbeut gjithashtu e gdhendur në relief.

Rreth e qark medaljes gdhendur në relief është shkruar Republika e Shqipërisë - Kryeministri.

Në pjesën e pasme të medaljes është e gdhendur në relief godina e Kryeministrit dhe nën të është shkruar dhe titulli i medaljes "Për Vlerësim Profesional"

Në pjesën sipër të medaljes janë tre hallka, ku në hallkën më të madhe kalon dhe shiriti i medaljes në ngjyrë të zezë me dy shirita të kuq anash. Gjërësia e shiritit është 38mm, gjatësia 50mm. Në pjesën e sipër mbrapa është qepur në medalje kapsja e medaljes realizuar sipas standartit të medaljeve në botë sot.

Materiali: Medalja është e gjitha në Bronz e galvanizuar në Ar (Au 1000/1000) me shtresë të ndermjetme Palladium.

E gjithë medalja është veshur me një shtresë lacquer (llak) e cila e mbron nga oksidimi.

Shiriti i medaljes është mëndafsh i ujëzuar ngjyrë e zezë me dy shirita të kuq në skaje.

MEDALJA E ARGJENDTË PËR VLERËSIM PROFESIONAL



Përshkrimi: Medalja e Argjendtë për Vlerësim Profesional ka diametër 40mm dhe spesor 3mm.

Në qendër të saj është e vendosur emblema e Kryeministrit, Shqipëria dykrenare e gdhendur në relief mbi të cilën është vendosur përkrenarja e Skënderbeut gjithashtu e gdhendur në relief.

Rreth e qark medaljes gdhendur në relief është shkruar Republika e Shqipërisë - Kryeministri.

Në pjesën e pasme të medaljes është e gdhendur në relief godina e Kryeministrit dhe nën të është shkruar dhe titulli i medaljes "Për Vlerësim Profesional"

Në pjesën sipër të medaljes janë tre hallka, ku në hallkën më të madhe kalon dhe shiriti i medaljes në ngjyrë të zezë me dy shirita të kuq anash. Gjerësia e shiritit është 38mm, gjatësia 50mm. Në pjesën e sipër mbrapa është qepur në medalje kapsja e medaljes realizuar sipas standartit të medaljeve në botë sot.

Materiali: Medalja është e gjitha në Bronz e galvanizuar në Argjend (Ag 1000/1000) me shtresë të ndermjetme Palladium.

E gjithë medalja është veshur me një shtresë lacquer (llak) e cila e mbron nga oksidimi.

Shiriti i medaljes është mëndafsh i ujëzuar ngjyrë e zezë me dy shirita të kuq në skaje.

MEDALJA E BRONXTË PËR VLERËSIM PROFESIONAL



Përshkrimi: Medalja e Bronxtë për Vlerësim Profesional ka diametër 40mm dhe spesor 3mm.

Në qendër të saj është e vendosur emblema e Kryeministrit, Shqiponja dykrenare e gdhendur në relief mbi të cilën është vendosur përkrenarja e Skënderbeut gjithashtu e gdhendur në relief.

Rreth e qark medaljes gdhëndur në relief është shkruar Republika e Shqiperisë - Kryeministri.

Në pjesën e pasme të medaljes është e gdhëndur në relief godina e Kryeministrit dhe nën të është shkruar dhe titulli i medaljes "Për Vlerësim Profesional"

Në pjesën sipër të medaljes janë tre hallka, ku në hallkën më të madhe kalon dhe shiriti i medaljes në ngjyrë të zezë me dy shirita të kuq anash. Gjerësia e shiritit është 38mm, gjatësia 50mm. Në pjesën e sipër mbrapa është qepur në medalje kapsja e medaljes realizuar sipas standartit të medaljeve në botë sot.

Materiali: Medalja është e gjitha në Bronz e tonuar.

E gjithë medalja është veshur me një shtresë lacquer (Ilak) e cila e mbron nga oksidimi.

Shiriti i medaljes është mëndafsh i ujëzuar ngjyrë e zezë me dy shirita të kuq në skaje.